



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIMAL  
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM  
NR 39 DATË 09.07.2021

**MBI MIRATIMIN E PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESËM VENDOR 2022-2024 PËR BASHKINË DIMAL.**

Këshilli i Bashkisë Dimal në mbledhjen e tij të datës 09/07/2021, bazuar në informacionin dhe materialin e paraqitur nga Drejtoria e Financës në Bashkinë Dimal, në mbështetje dhe zbatim të Ligjit Nr 139/2015 "Për Vetëqeversijes Vendore", në përputhje me Neni 4, Neni 24, Neni 54, Neni 55, të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, në Nenin 6, 36 të Ligjit Nr 68/2017 datë 27.04.2017 "Për Financat e Vetë Qeverisjes Vendore" "Udhëzimi Nr 7 datë 26.02.2022, "Për Përgatitjen e Programit Buxhetor AfatMesëm Vendore 2022-2024", materialin e përgatitur nga Grupi i punës për hartimin e "PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESËM VENDOR 2022-2024 për BASHKINË DIMAL" Shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit Drejtoria e Financave Vendore me Nr 10877Prot Tiranë më 18/06/2021, protokolluar në Institucionin tonë me Nr 126/12Prot datë 22/06/2021 "Dërgohen mendimet mbi Programin Buxhetor Afat Mesëm 2022-2024 Ligj Nr 34/2021 datë 16.03.2021 "Për Ndryshimin e Emërtimeve të Njësisë së Qeverisjes Vendore nga "Bashkia Ura Vajgurore" në "Bashkia "Dimal", Fletore Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, Numri 55 e Enjte, 8 Prill 2021.

**VENDOSI:**

**Me 14 vota nga 14 Këshilltarë prezentë të miratojë :**

1. Të miratojë "Programin Buxhetor Afat Mesëm Vendor 2022-2024", për Bashkinë Dimal, sipas materialit bashkëlidhur vendimit.

Kryetar i Këshillit Bashkiak  
Hysen Hoxha



